

URDHËR
Nr. 32, datë 12.11.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PËRCAKTIMIN E
PROCEDURËS SË INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I RREGULLT
ADMINISTRATIV”, MIRATUAR ME URDHRIN NR. 25, DATË 10.8.2018, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”:

URDHËROJ:

1. Në rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:
“Në aneksin 1 të rregullores, formati standard nr. 11, ‘Vendim i Komisionit të Ankimit’, zëvendësohet me formatin standard me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij urdhri.”.
2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore dhe/ose strukturat përgjegjëse të inspektimit për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DREJTORIA RAJONALE _____

**VENDIMI
I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT**

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Emërtimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit _____

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar, të cilit i referohet vendimi përfundimtar (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. _____, datë _____, “Për krijimin dhe organizimin e ISH” dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë _____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar) (kjo pjesë plotësohet nga sistemi).

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë _____

(shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ/citimi i dënimit kryesor dhe plotësues sipas vendimit përfundimtar të inspektimit kundër të cilit është bërë ankimi), Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit arsyeton _____

Në konkluzion, Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit, si dhe morri në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar pranë _____

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐

3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar ☐

4. Mospranimin e ankimit ☐

(Në printim të shfaqet vetëm opsioni që ka vendosur Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit)

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

1. KRYETARI

(Nënshkrimi dhe vula e institucionit)

2. ANËTAR
(Nënshkrimi)

4. ANËTAR
(Nënshkrimi)

3. ANËTAR
(Nënshkrimi)

5. ANËTAR
(Nënshkrimi)

Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.